

## BANKA E SHQIPËRISË

*Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:  
[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)*

*Nëse dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

*Banka e Shqipërisë  
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,  
Tel.: +355-(0)4-222152;  
Faks: +355-(0)4-223558*

*ose duke dërguar një e-mail në adresën:  
[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)  
Tirazhi: 1000 kopje*

# Llogaritë Rrjedhëse



## ÇFARË ËSHTË LLOGARIA RRJEDHËSE?

Klienti (individ) administron sasinë e parave që ai ka nga rroga apo kursimet duke i vendosur në një nga bankat që zhvillojnë aktivitet në vend. Banka të ndryshme të ofrojnë paketa të ndryshme.

Llogaria mund të hapet në Lekë, Euro dhe Usd. Llogaria rrjedhëse ndryshon nga depozita, pasi nga llogaria mund t'i tërheqësh paratë në çdo moment dhe banka nuk të aplikon asnjë interes, ndërsa me depozita përfiton interesa që i merr në fund të periudhës së maturimit.

## DOKUMENTE TË NEVOJSHME PËR HAPJEN E LLOGARISË RRJEDHËSE.

Për të hapur një llogari rrjedhëse do të duhej dokumenti juaj i identifikimit.

## ÇFARË INFORMACIONI DUHET TË DINI PARA SE TË APLIKONI PËR HAPJEN E NJË LLOGARIE RRJEDHËSE.

Ka dy mënyra shfrytëzimi (pagese) të llogarisë rrjedhëse: ÇEK, KARTË dhe transferta.

Domethënë, në qoftë se ju dëshironi të paguani një faturë, atëherë mund të përdorni njërin nga të dyja.

- \* A fiton interesa nga hapja e një llogarie? Nëse po, sa dhe cilët faktorë mund të rrisin apo zvogëlojnë përqindjen e interesit? Në përgjithësi, ju nuk përfitoni interesa nga hapja e një llogarie rrjedhëse, vetëm në ndonjë rast të veçantë.
- \* Cilat janë komisionet? Ju duhet të dini nëse ka një komision për hapjen, mbylljen, mirëmbajtjen e llogarisë apo për depozitimet dhe tërheqjet.

## PËRFITIMET DHE AVANTAZHET.

- \* Mund të kryeni pagesa të faturave të ndryshme si telefonike të energjisë etj..
- \* Mund të derdhni pagën tuaj.
- \* Mund të pajiseni me karta krediti.
- \* Mund të merrni dhe të lëshoni çeqe udhëtarësh.
- \* Mund të kryeni transferta në të gjithë botën.
- \* Mund të keni kushte lehtësuese për kredi.
- \* Mund të përfitoni paradhënie bankare ose mbitërheqje të hollash nga banka (overdraft). Në disa banka ju mund ta përfitoni automatikisht këtë paradhënie, ndërsa në raste të tjera ju mjafton një kërkesë.

## PENALIZIMET.

Nga "Llogaria Rrjedhëse" mund të tërhiqni vetëm paratë që keni futur, dhe në qoftë se e kaloni shifrën që keni depozituar, jeni të detyruar ta paguani me interesin më të lartë që ka banka.